

## NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Rënda, duke vendosur sipas kryetarit te trupit gjykues Naser Maliqi, ne çeshtjen penale kundër të të akuzuarit Sh. Z. me vendbanim në fshatin S., Komuna e I., të cilin e mbron me autorizim av. Y. H. nga Gj., per shkak te vepres penale “kontrabandimi me migrantë” nga neni 170 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krimet e Renda, PP.I.nr.262/2014 e dt. 04.12.2014, e pas mbajtjes e shqyrtimit gjyqësor me dt. 25. 10. 2016, shpalle:

## AKTGJYKIM

**Ndaj te pandehurit Sh.**, nga babai N. dhe e ëma H., e lindur H., i lindur më ... në fshatin S., Komuna e I., ku edhe banon, përkohësisht punon në Z., ka të kryer ..., I martuar, me gjendje të varfër ekonomike, I martuar, baba I ... fëmi, shqiptar, shtetas I Republikës së Kosovës.

## ESHTE FAJTOR

Sepse

Me datë ....10.2014, rreth orës ... minuta në fshatin K. - R., me rastin e ndaljes dhe kontrollimit të veturës së markës ..., me targa të A., me tabela të regjistrimit ..., ngjyrë e ..., nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, i pandehuri me qëllim të përfitimit të drejtëpërdrejtë të dobisë financiare apo të dobisë tjetër pasurore, ka kontrabanduar emigrant në atë mënyrë që të dëmtuarit, V. H., B. V. dhe A. D. është angazhu për t'i dërguar së pari në Republikës e Serbisë, e më pastaj në shtete të tjera të Europës Perëndimore, por i njëjti është hetuar nga policia e Kosovës Stacioni Policor në Muqiverrc dhe së bashku me të dëmtuarit shoqërohet për në polici

- me çka kryer veprën penale kontrabandim me migrant nga neni 170 paragrafi 1 të KPRK-së

Sepse me qëllim të përfitimit të drejtëpërdrejtë të dobisë së kundërligjshme pasurore, ka organizuar kontrabandim të migrantëve, ashtu që paraprakisht ka arritur marrëveshje me të dëmtuarit S. R., B. R. dhe K. B., që t'i dërgojë deri në Hungari dhe për këtë të njëjtit t'i paguajnë nga 300 Euro secili, ashtu që ditën kritike me datë ....11.2014 ka organizuar transportimin e të njëjtëve në mënyrë ilegale, duke paguar 10 Euro një veturë Taxi që t'i dërgojë nga Gj. deri në B. - S., mirëpo me të arritur në pikën kufitare Dheu i Bardhë, rreth orës ... h, të njëjtit ndalen për kontroll nga ana e zyrtarëve të policisë kufitare, me ç'rast vërtetohet se qëllimi i tyre ishte migrimi në mënyrë të paligjshme në shtetet e BE-së dhe i njëjti arrestohet.

- Me cka ka kryer veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 170 paragrafi 1 të KPRK-së.

- Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore nën 4, 7, 17, 21, 41, 43, 45, 47, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së, si dhe nën 326, 365 dhe 451 dhe të KPRK-së,

## E GJYKON

Me dënim me gjobë prej 200 (dyqind) Euro dhe me dënim burgu në kohezgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditë në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim prej 12.11.2014 e deri më 21.11.2014 si dhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak prej 21.11.2014 deri 24.02.2015, ashtu që të akuzuarit I mbeten për t'u vuajtur dënimi me burg në kohezgjatje prej 72 (shtatëdhjetë) ditë, **I cili dënim me kërkesën e të akuzuarit I shëndërrohet në dënim me gjobë prej 1.000,00 (njimije) Euro, ashtu që të akuzuarit I shqiptohet dënim unik me gjobe në shume prej 1.200,00 (njimije e dyqind) euro, të cilin do ta paguajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në 6 këste të barabarta.**

**Detyrohet** i pandehuri K. M. qe ti paguaj shpenzimet e procedurës sipas llogarisë perfundimtare te gjykatës, ndërsa ne emër te paushallit gjyqësor shumën prej 20 Euro.

## **A R S Y E T I M**

**Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti per Krime te Renda**, me dt. 21.11.2014, ka ngritur aktakuzen PP.I.nr.271/2014, ndaj te akuzuarit K. M., per shkak te vepres penale“kontrabandimi me migrantë” nga neni 170 paragrafi 1 te KPRK-se dhe ka kerkuar që pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor, I njejtë te shpallet fajtor dhe te denohet me denim meritor sipas ligjit.

Ne shqyrtim gjyqësor te dt. 21.10.2016, i pandehuri K. M. e ka pranuar ne tërësi vepren penale e cila i vihet ne barre ne te gjitha pikat e aktakuzes, e ndien veten fajtor dhe ka kerkuar falje dhe se eshte penduar per vepren te cilen e ka kryer.

Gjykata e ka aprovuar kete pranim te fajesise, pas marrjes se mendimit nga prokurori i shtetit dhe nga mbrojtësi i te akuzuarit dhe nga vet I akuzuari.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajesise, per shkak se ky pranim eshte bere ne menyre vullnetare, pa imponim dhe pa asnje presion, duke I ditur pasojat e pranimit te fajesise nga ana e te akuzuarit.

Në fjalën përfundimtare prokurori I shtetit ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, ka kërkuar që të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi I të pandehurit av. S. M. ka kërkuar që gjatë marrjes së vendimit gjykata të ketë parasysh rrethanat lehtësuese, sjelljen e mire në gjykatë, e ka pranuar veprën, nuk ka kryer vepra penale dhe ka kërkuar që të njëjtit t’I shqiptohet një denim I kushtëzuar e nëse I shqiptohet një denim efektiv me burg, I njëjti t’I zëvendësohet në denim me gjobë.

I akuzuari K. M. e mbështet në tërësi fjalën e avokatit të tij pa ndryshim dhe plotësim, kërkon falje për veprën e kryer, I ka

premtuar gjykatës se më kurrë nuk do ta përsëris veprën e tij e as të tjera që bien ndesh me ligjin.

Gjate matjes dhe shqiptimit të denimit, Gjykata ka patur parasysh sjelljen e mirë të të akuzuarit në Gjykatë, pranimin e fajësive nga ana e të pandehurit pa asnjë hezitim i cili pranim është në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës: procesverbalet mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarëve, forma daktiloskopike, informacionet e të pandehurit si dhe fotodokumentacioni, e poashtu edhe pendimin e tij për veprën e kryer, ka kërkuar falje, nuk ka kryer me veper penale, sjellja e mirë në gjykatë.

Për këtë arsye gjykata i shqiptoi një dënim me gjobe në lartsi prej 200 euro, dhe dënim me burg në kohezgjatje prej 180 ditësh, në të cilin i është llogaritur koha e qëndrimit paraburgim dhe arrest shtepiak sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa pjesa e mbetur e denimit me burg, me kërkesën e avokatit mbrojtës, të cilin e ka mbeshtetur edhe i akuzuari K. M. I është zëvendësuar me dënim me gjobe në shumë prej 1.000 euro, ashtu që të akuzuarit i është shqiptuar dënimi unik me gjobe në shumë prej 1.200 euro, të cilin do ta paguaj pas plotfuqishmeris së aktgjykimit, në gjashtë keste të barabarta.

Gjykata të pandehurin e ka detyruar, që kësaj Gjykate t'ia paguaj shumën paushalle prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogarise perfundimtare të kësaj Gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**  
**Me dt. 21.10.2016**

**Zyrtar Ligjor,**  
**Zahide Rexhepi**

**Kryetari I trupit:**  
**Naser Maliqi**

**KSHILLA JURIDIKE:** kunder këtij aktgjykimi, palet e paknaqura munde të ushtrojne ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nepermjet kësaj Gjykate.

## **VERTETOJNE**

**Sekretare Juridike:**

**Zahide Rexhepi**

**Kryetari i Trupit :**

**Naser Maliqi**

I akuzuari eshte i obliguar qe me rastin e ndryshim te adresës ta lajmëroj gjykatën.

Palët ne procedure njoftohen se kane te drejte te paraqesin ankese kundër këtij aktgjykimi.

**Sekretare Juridike**

**Kryetari i Trupit**

Kryetari i trupit pas dëgjimit të palëve mori këtë

### A k t v e n d i m

PRANOHET pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së lartcekur, ngase kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Kryetari i trupit gjykues vlerëson se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri pas konsultimeve me mbrojtësin e tij se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çartë ligjore ose gabime faktike.

Pa vërejtje.

Meqenëse nuk ka propozime tjera kryetari i trupit gjykues vlerëson se shqyrtimi fillestar duhet të vazhdojë me shqiptimin e dënimit dhe se tërhiqet për ta marr aktgjykimin.

Publikimi i aktgjykimit do të bëhet në ora 10,00.

**Përfundoi në ora 9,33 minuta**

**Prokurori i shtetit  
pandehurit,**

**Mbrojtësi i të**

**E dëmtuara,  
pandehuri**

**I**

**Vërtetojnë:**

**Sekretarja juridike,  
gjykues,**

**Kryetari i trupit**

Prokurori Isuf Sadiku deklaron: meqenëse ne kemi arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë konsiderojë se janë plotësuar kushtet ligjore që ta pranojë një marrëveshje të tillë.

Për një gjë të tillë ne kemi patur edhe autorizim edhe nga Kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kemi nënshkruar ne së bashku duke përfshirë këtu Kryeprokurorin, të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe unë si prokuror i çështjes.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Sherif Sherifi, deklaron: konsiderojë se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore konform dispozitave të nenit 233 të KPRK dhe mendoj se një marrëveshje e tillë është bërë edhe me dëshirën dhe vullnetin e të pandehurit Ali, ngase qysh në

fazën e hetimeve i njëjti ka treguar një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Prokurorinë dhe është penduar thellë për rastin që ka ndodhur andaj, konsiderojë se marrëveshja e tij është e bazuar me ligj dhe i propozojë gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi.

I pandehuri deklaron: marrëveshjen për pranimin e fajësisë e kam nënshkruar në mënyrë vullnetare, jam i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht jam konsultuar me mbrojtësin tim, jam penduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk kam qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje.

Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve si dhe pas leximit dhe shiqimit paraprak të gjitha shkresave të lëndës duke u bazuar në nenin 233 paragrafi 21 dhe nenin 247 paragrafi 1 i KPP mori këtë

#### A k t v e n d i m

- I. **PRANOHET** marrëveshja për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të PTHDPKR në njërën anë dhe të pandehurit dhe mbrojtësit të tij av. në anën tjetër për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës KP.nr.230/13 e dt.04.09.2013 ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.
- II. Kryetari i trupit gjykues vlerëson se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që ta pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat janë të paraqitura në aktakuzë dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parashikuara në nenin 253 paragrafit 1 dhe 2 të KPP.
- III. URDHËROHEN referentët e kësaj gjykate që marrëveshjen e lartcekur mbi pranimin e fajësisë ta vendosin në shkresat e kësaj lënde.

Pa vërejtje.



Prokurori Isuf Sadiku dhe mbrojtësi i të pandehurit av.Sherif Sherifi i propozojnë kryetarit të trupit gjykues që seanca e dëgjimit lidhur me dënimin të mbahet të hënën ngase e kanë të ngarkuar agjendën me gjykime tjera.

Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve duke u bazuar në nenin 233 paragrafi 21 fjalia e dytë e KPP mori këtë

## A k t v e n d i m

APROVOHET propozimi i prokurorit dhe i mbrojtësit të pandehurit që seanca e dëgjimit lidhur me dënimin të mbahet menjëherë tani.

Pa vërejtje.

Prokurori Isuf Sadiku gjatë deklaratës së tij lidhur me dënimin shtojë: për propozimin për këtë dënim prej 6 muajve me burgim efektiv dhe dënim me gjobë prej 500 euro si dënim unik për dy vepra që përmban aktakuza kemi marrë për bazë se I pandehuri prej fillimit të procedurës ka qenë cooperative me institucionet e drejtësisë, policinë, prokurorinë, ka pranuar fajsinë, është penduar thellë për kryerjen e këtyre dy veprave penale, se më parë nuk ka qenë asnjëherë I denuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe se sigurisht që avokati ka marrë pëlqimin e tij për të bërë një kërkesë për pranimin e fajsisë për dy vepra të kryera.

Sa i përket masës së paraburgimit ia lë gjykatës në competence që të vendos.

Poashtu propozojmë që conform nenit 62 paragrafi 2.7 të KPRK të bëhet konfiskimi I armës "AK 47", dy karikatorëve dhe 28 fishekëve.

Mbrojtësi I të pandehurit av.Sherif Sherifi, deklaron: I pranojmë deponimet e prokurorisë lidhur me rrethanat shfajësuese të pandehurit dhe të njejtat janë të bazuara dhe reale sa I përket dënimit të arritur me marrëveshjen në mes të Prokurorisë dhe të pandehurit Ali dhe mendojmë se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi I tij ashtu siç është kërkuar në KPRK, ndërsa sa I përket masës së paraburgimit mendojmë se kanë pushuar të gjitha kushtet ligjore për të cilat është caktuar kjo masë nga ana e gjykatës, aq më tepër

pas arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajsisë, andaj, I propozojmë gjykatës që ndaj të pandehurit Ali masa e paraburgimit të caktuar me dt.25.08.2013 ti ndërprehet.

Në këtë faze të procedurës mbrojtësi I të pandehurit av.Sherif Sherifi deklaron: pasiqë në marrëveshjen mbi pranimin e fajsisë mbrojtja dhe prokuroria si dhe I pandehuri janë pajtuar me lartësinë e denimit e cila ka qenë 6 muaj burg e duke u bazuar në dispozitat e KPRK përkatësisht nenit 47, gjykatës I propozojë që lartësia e denimit prej 6 muaj burg të zëvendësohet me denim me gjobë të llogaritur sipas kësaj gjykate ngase për një propozim të fillë në konsultim me të pandehurin Ali jemi informuar se I njejtë është në gjendje financiare që ta përballojë një denim të fillë.

Meqë është prezentë I njejtë lusim gjykatën që lidhur me këtë të merr pëlqimin e të pandehurit Ali.

I pandehuri Alija Bajramoviq deklaron: pajtohem me deklaratën e mbrojtësit tim dhe e njoftojë gjykatën se jemi pajtuar me familjen e të dëmtuarit. Gjykatës I premtojë që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale.

Prokurori Isuf Sadiku deklaron: Sa I përket propozimit të mbrojtësit për zëvendësimin e denimit prej 6 muaj burg, me denim me gjobë theksojë se ia lë gjykatës që të vendos lidhur me këtë propozim conform dispozitave të Republikës së Kosovës.

Meqenëse nuk ka propozime tjera kryetari I trupit gjykues tërhiqet për ta marrë aktgjykimin, ndërsa publikimi I aktgjykimit do të bëhet në ora 12,10.

**Përfundoi në ora 11:45**

**Prokurori i shtetit  
pandehurit**

**Mbrojtësi i të**

**I pandehuri**

**V ë r t e t o j n ë :**

**Sekretarja juridike,  
gjykues,**

**Kryetari i trupit**